# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2020 – Numri: 184

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E premte, 16 tetor 2020**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret i Presidentit nr. 11779, datë 13.10.2020 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare........................................................... | 12637 |
| Dekret i Presidentit nr. 11780, datë 13.10.2020 | Për dhënie të shtetësisë shqiptare........................................................... | 12637 |
| Dekret i Presidentit nr. 11781, datë 13.10.2020 | Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare............................................ | 12638 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 798, datë 12.10.2020 | Për disa ndryshime në vendimin nr. 17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale".................................................... | 12638 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 804, datë 30.9.2020 | Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 143, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit"..................................................... | 12639 |
| Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4573/10, datë 16.10.2020 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit "tokë truall", "ullishte" dhe "vegjetacion", që preken nga realizimi i projektit "Rikostruksion dhe zgjerim i rrugës 'Muzak Topia', segmenti nga rrethrrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te kisha e 'Shën Ilias', Berat"....................... | 12640 |
| Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 7257, datë 14.10.2020 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit "tokë truall", që preken nga projekti "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës 'Fortuzi'", Tiranë...... | 12643 |

**DEKRET**
**Nr. 11779, datë 13.10.2020**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Dastid Sadri Ferati
2. Afërdita Ramiz Janova (Demaku)
3. Besnik Hashim Janova
4. Besnik Musa Jakupi
5. Driton Adem Hysenaj
6. Granit Bujar Hyseni
7. Arian Tafil Mavriqi
8. Alban Isaj Shala
9. Artan Mursel Behrami
10. Delfina Osman Krasniqi Behrami (Krasniqi)
11. Ardian Nue Kolaj
12. Arta Xhevdet Hasimja Efendija (Hasimja)
13. Behar Fehmi Efendija
14. Valdet Ahmet Gjinovci
15. Ngadhnjim Rexhep Kastrati
16. Xhevat Azir Syla
17. Astrit Tosun Kryeziu
18. Xhavit Ali Aliaj
19. Ilir Hajrush Shala
20. Fisnik Skender Korenica
21. Dren Zija Doli
22. Adriatik Flamur Kelmendi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**

**DEKRET**
**Nr. 11780, datë 13.10.2020**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, germa "c", dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Lumni Halil Sallauka
2. Arsim Sylejman Hamzaj
3. Valon Sejdullah Totaj
4. Armend Aziz Podvorica
5. Veli Bajram Hoti
6. Anton Nikollë Selitaj
7. Enver Shaban Selimi
8. Dorontina Rexhep Ponxha
9. Ruzhdi Qazim Krasniqi
10. Fisnik Vehbi Gecaj
11. Besnik Abdyl Xhemaili
12. Rezarta Ismet Jakupi (Zeka)
13. Armend Rexhep Jakupi
14. Dorina Armend Jakupi
15. Shkelzen Hazir Morina

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**

**DEKRET**
**Nr. 11781, datë 13.10.2020**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Xheni Shefqet Meda
2. Ansana Flamur Valteri
3. Albert Omer Krasniqi
4. Robertamaria Filip Melonashi
5. Elisabeta Dalip Minaj
6. Xhersi Besnik Qershori
7. Elisabeta Kujtim Pisku (Zeka)
8. Liam Nico Erjon Pisku
9. Noah Erjon Pisku
10. Erjon Besnik Pisku
11. Denada Pandeli Mone
12. Jetmir Bashkim Boletini

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
**Ilir Meta**

**VENDIM**
**Nr. 798, datë 12.10.2020**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 15.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E PROGRAMEVE TË NXITJES SË PUNËSIMIT NËPËRMJET PUNËSIMIT, FORMIMIT NË PUNË DHE PRAKTIKAVE PROFESIONALE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 4, të kreut II, të vendimit nr. 17, datë 15.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën "a", fjalët "... shoqëri tregtare të regjistruara ..." zëvendësohen me "... persona fizikë apo juridikë të regjistruar ...".

b) Në shkronjën "e", fjalët "... shoqëri tregtare ..." zëvendësohen me "... persona fizikë apo juridikë ...".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**VENDIM**
**Nr. 804, datë 30.9.2020**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 143, DATË 13.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT, PËR SUBJEKTET E RINDËRTIMIT DHE PËR PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR TË FURNIZIMIT TË MALLRAVE E SHËRBIMEVE, PËR QËLLIME TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 53, shkronjat "l" e "ll", dhe 56, pika 28, të ligjit nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 143, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Në nenin 3, pas shkronjës "c" shtohet shkronja "ç", me këtë përmbajtje:

"ç) nënkontraktorët, të cilët kanë lidhur kontrata me ndërtuesit/kontraktorët e përcaktuar në shkronjat "a", "b" dhe "c", të këtij neni, për furnizimin e proceseve të ndërtimit, si dhe furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar.".

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Neni 4

Për qëllime të zbatimit të përjashtimeve të mësipërme, subjektet e përcaktuara në nenin 3, të këtij vendimi, duhet të jenë të autorizuara nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Për t'u pajisur me autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja, paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me shkrim, së cilës i bashkëlidhet një fotokopje e certifikatës së NIPT/NUIS-it;

b) Marrëveshjen kuadër, që kanë lidhur me njësinë zbatuese për secilën procedurë prokurimi publik të programit të rindërtimit, sipas parashikimeve në ligjin e fushës, në rastin e ndërtuesit/kontraktorëve;

c) Marrëveshjen e bashkëpunimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorit, në rastet kur ndërtuesi, subjekt i rindërtimit, është përcaktuar nga donatori që ka marrë përsipër procesin e ndërtimit, në përputhje me programin e rindërtimit;

ç) Preventivin e punimeve, mbi bazën e të cilit janë përzgjedhur fitues për kontratat publike për punime/shërbime ndërtimi, në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, shoqëruar kjo me listën e detajuar të materialeve që do të përdoren në procesin e ndërtimit, në rastin e ndërtuesit /nënkontraktorëve;

d) Kopjen e lejes së ndërtimit, të miratuar nga organet kompetente, në rastin e ndërtuesve;

dh) Kontratën e lidhur me ndërtuesin /kontraktorin, në rastin e furnizuesve të mallrave ose të shërbimeve që furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar, kontraktorë /nënkontraktorë.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune, nga data e dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton kërkesën e paraqitur nga subjektet e rindërtimit. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, njoftohet kërkuesi për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e dokumentacionit brenda një afati pesëditor.

Bazuar në rezultatet e shqyrtimit, kur përmbushen kërkesat e përcaktuara dhe është plotësuar dokumentacioni i sipërpërmendur, drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga paraqitja e kërkesës, lëshon autorizimin e përjashtimit nga TVSH-ja për subjektet e rindërtimit.

Një kopje e autorizimit, së bashku dokumentacionin shoqërues i përcillet drejtorisë rajonale tatimore përkatëse, që ka në administrim tatimpaguesin, subjekt të rindërtimit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen zyrtare dhe mban të përditësuar listën e subjekteve të rindërtimit, të cilat janë pajisur me autorizim përjashtimi nga TVSH-ja, ku pasqyrohen të dhënat identifikuese të tatimpaguesit,

NIPT/NUIS-i, numri dhe data e lëshimit të autorizimit.

Furnizuesit e mallrave/shërbimeve të përjashtuara nga TVSH-ja për procesin e ndërtimit, në momentin e lëshimit të faturës tatimore duhet të shënojnë në faturë dispozitën ligjore, sipas së cilës furnizimi është i përjashtuar, si dhe numrin e datën e autorizimit të përjashtimit.

Gjithashtu, furnizuesi i bashkëlidh kopjes së faturës tatimore, që mban vetë, edhe një kopje të autorizimit të përjashtimit.

Asnjë përjashtim nuk akordohet për furnizuesit e mallrave ose të shërbimeve që nuk furnizojnë direkt ndërtuesit e autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Ndërtuesit, subjekte të rindërtimit, të cilat i importojnë vetë mallrat që do të përdoren prej tyre për procesin e ndërtimit, pas marrjes së autorizimit të përjashtimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, paraqiten pranë autoritetit doganor për të përfituar përjashtimin në import për këto mallra.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton procedurë/manual të posaçëm, me qëllim kontrollin e zbatimit të përjashtimeve, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar.”.

Neni 3
**Hyrja në fuqi**

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

**KËRKESË**
**Nr. 4573/10, datë 16.10.2020**

**PËR SHPRONËSIM**
**PËR INTERES PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit “tokë truall”, “ullishte” dhe “vegjetacion”, që preken nga realizimi i projektit “Rikostruksion dhe zgjerim i rrugës ‘Muzak Topia’, segmenti nga rrethrrotullimi tek ish-Rezervat e Shtetit deri te kisha e ‘Shën Ilias’, Berat”. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private (sipas tabelës bashkëlidhur), të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur duke u bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, i ndryshuar. Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, si dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

Vlera totale e shpronësimit është 16,399,997 (gjashtëmbëdhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
**Artan Shkreli**

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA RIKONSTRUKSION DHE ZGJERIM I RRUGËS "MUZAK TOPIA", SEGMENTI NGA RRETHRROTULLIMI TEK ISH-REZERVAT E SHTETIT DERI TE KISHA "SHËN ILIA" BERAT

| | STATUSI JURIDIK | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT Ë PASURISË | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | PRIVAT | | Nr. | Lloji i | Sip. | Shpronësim tokë "ullishte" | | | Shpronësim tokë "truall" | | | Vegjetacion i | VLERA | |
| Nr. | Emri Atësia Mbiemri | Zona Kadastrale | pas. | pas. | totale (m²) | Sip. (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë) | Sip. (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë) | Vlera (lekë) | TOTALE (lekë) | SHËNIME |
| 1 | Shtet | 8501 | 18/39 | Truall | 1364 | | | | 16.29 | **0** | **0** | **0** | **0** | |
| 2 | Myrteza Rexhep Muçaj | 8501 | 18/143 | Truall | 305 | | | - | 10.26 | 4,183 | 42,918 | | 42,918 | |
| 3 | Shtet | 8501 | 18/317 | Truall | 41 | | | - | 3.69 | 4,183 | 15,435 | | 15,435 | Bedri Osoja (Okupuar) |
| 4 | Shtet | 8501 | 18/318 | Truall | 297.00 | | | | 3.61 | - | - | | - | |
| 5 | Shtet | 8501 | 18/322 | Truall | 795 | | | - | 1.03 | 4,183 | 4,308 | | 4,308 | Shefit Pelivan bani (Okupuar) |
| 6 | Shtet | 8501 | 18/323 | Truall | 780 | | | | 74.19 | - | - | | - | |
| 7 | Shtet | 8501 | 4/65 | Truall | 829 | | | - | 31.48 | 4,183 | 131,681 | 20,000 | 151,681 | Syri Qalliu (Okupuar) |
| 8 | Shtet | 8501 | 18/361 | Truall | 496 | | | - | 4.48 | 4,183 | 18,740 | | 18,740 | Myrteza Rakip Shkoza (Okupuar) |
| 9 | Shtet | 8501 | 18/329 | Truall | 198 | | | - | 34.85 | 4,183 | 145,778 | | 145,778 | Flamur Kadri Seitaj (Okupuar) |
| 10 | Shtet | 8501 | 18/310 | Truall | 440 | | | - | 88.64 | 4,183 | 370,781 | | 370,781 | Naum Bani (Okupuar) |
| 11 | Shtet | 8501 | 16/255 | Pyll | 656 | | | | 284.15 | - | - | | - | |
| 12 | Polikseni Nano | 8505 | 725 | Ullishte | 5,000 | 451.43 | 1,800 | 812,574 | | | - | 110,000.0 | 922,574 | |
| 13 | Kozma Dhimo Vrusho | 8505 | 726 | Ullishte | 2,000 | 65.00 | 1,800 | 117,000 | | | - | 20,000.0 | 137,000 | |
| 14 | Algerta Vladimir Frasheri | 8505 | 730/1 | Ullishte | 255 | 132.98 | 1,800 | 239,364 | | | - | 10,000 | 249,364 | |
| 15 | Hajrije Ali Agalliu | 8505 | 730/2 | Ullishte | 980 | 277.48 | 1,800 | 499,464 | | | - | 24,000.0 | 523,464 | |
| 16 | Myqerem Adem Kreku | 8505 | 729/2 | Ullishte | 1,000 | 261.01 | 1,800 | 469,818 | | | - | | 469,818 | |
| 17 | Gramoz Kreku | 8505 | 729 | Ullishte | 1,000 | 56.14 | 1,800 | 101,052 | | | - | 10,000 | 111,052 | |
| 18 | Baftjar Kreku | 8505 | 729/1 | Ullishte | 900 | 40.59 | 1,800 | 73,062 | | | - | | 73,062 | |
| 19 | Vlashi Vasil Pambuku | 8505 | 737/3 | Ullishte | 4,000 | 321.17 | 1,800 | 578,106 | | | - | 56,000 | 634,106 | (Seksioni E-vendoset masa e sekuestros nga përmbarimi) |
| 20 | Gjergji Kalldremxhi & Aleksander Kalldremxhi | 8505 | 737/2 | Ullishte | 2,000 | 160.00 | 1,800 | 288,000 | | | - | 10,000 | 298,000 | |
| 21 | Gjergji Kalldremxhi & Aleksander Kalldremxhi | 8505 | 737/1 | Ullishte | 2,000 | 414.90 | 1,800 | 746,820 | | | - | 80,000 | 826,820 | |
| 22 | Bujar Molishti | 8505 | 752 | Ullishte | 3,200 | 283.07 | 1,800 | 509,526 | | | - | 10,000 | 519,526 | (Seksioni E-ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së) |
| 23 | Haki Molishti | 8505 | 755 | Ullishte | 3,000 | 26.00 | 1,800 | 46,800 | | | - | 16,000 | 62,800 | (Seksioni E-ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së) |
| 24 | Edmonda Llazar Tabaku | 8505 | 777 | Ullishte | 2,000 | 437.32 | 1,800 | 787,176 | | | - | 49,000 | 836,176 | |
| 25 | Tefta Sinjari | 8505 | 776 | Ullishte | 2,500 | 454.72 | 1,800 | 818,496 | | | - | 40,000 | 858,496 | Tefta Sinjari (Seksioni E-ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së) |
| 26 | Shahzivar Ibrahim Nuri | 8505 | 775 | Ullishte | 7,500 | 1,148.98 | 1,800 | 2,068,164 | | | - | 40,000 | 2,108,164 | |
| 27 | Tokli Bishka & Aleks Bishka & Nasi Bishka | 8505 | 772/2 | Ullishte | 4,200 | 409.01 | 1,800 | 736,218 | | | - | 20,000 | 756,218 | |
| 28 | Haki Molishti | 8505 | 754 | Ullishte | 4,200 | 216.31 | 1,800 | 389,358 | | | - | 28,000 | 417,358 | Haki Molishti (ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së) |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | Bujar Molishti | 8505 | 753 | Ullishte | 4,000 | 73.61 | 1,800 | 132,498 | | | - | 70,000 | 202,498 | Bujar Molishti (Seksioni E-ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së) |
| 30 | Gjergji Kalldremxhi & Aleksander Kalldremxhi | 8505 | 747 | Ullishte | 6,300 | 126.80 | 1,800 | 228,240 | | | - | 35,000 | 263,240 | |
| 31 | Shpetim Xhevit Qose | 8505 | 746 | Ullishte | 2,000 | 73.59 | 1,800 | 132,462 | | | - | 30,000 | 162,462 | |
| 32 | Vangjel Papajorgji & Spiro Papajorgji | 8505 | 738 | Ullishte | 4,000 | 321.18 | 1,800 | 578,124 | | | - | 11,000 | 589,124 | |
| 33 | Arben Tahiraj | 8505 | 735/3 | Ullishte | 7,550 | 3.32 | 1,800 | 5,976 | | | - | 20,000 | 25,976 | |
| 34 | Shtet | 8505 | 772/1 | Ullishte | 1,930 | 462.00 | 1,800 | 831,600 | | | | 10,000 | 841,600 | Naun Caco ( okupuar) |
| 35 | Shtet | 8505 | 737/6 | Ullishte | 514 | 9.00 | 1,800 | 16,200 | | | - | 10,000 | 26,200 | Vlash Pambuku (okupuar) |
| 36 | Shtet | 8505 | 737/4 | Ullishte | 1,224 | 103.00 | 1,800 | 185,400 | | | - | 50,000 | 235,400 | Gjergji Kalldremxhi (okupuar) |
| 37 | Sako Molishti | 8505 | 749 | Ullishte | 2,000 | 240.69 | 1,800 | 433,242 | | | - | 56,000 | 489,242 | (Seksioni E-ndalohen veprimet në këtë pasuri deri në zgjidhjen e problemit të AMT-së) |
| 38 | Shtet | 8505 | 767 | Ullishte | 8,076 | 265.62 | 1,800 | 478,116 | | | - | 14,000 | 492,116 | Ramadan Caco (Okupuar) |
| 39 | Shtet | 8505 | 748/1 | Ullishte | 406 | 246.71 | 1,800 | 444,078 | | | - | 80,000 | 524,078 | Sako Molishti (Okupuar) |
| 40 | Shtet | 8505 | 735/6 | Ullishte | 205 | 166.03 | - | - | | | | - | - | |
| 41 | Shtet | 8505 | 719 | Ullishte | 10,418 | 202.95 | 1,800 | 365,310 | | | - | 80,000 | 445,310 | Kristaq Tutulani (Okupuar) |
| 42 | Shtet | 8505 | 800/2 | Ullishte | 4,091 | 40.96 | 1,800 | 73,728 | | | - | | 73,728 | Kozma Koco Nova (Okupuar) |
| 43 | Shtet | 8505 | 734 | Ullishte | 3,130 | 185.77 | - | - | | | - | | - | |
| 44 | Shtet | 8505 | 754/1 | Ullishte | 532 | 38.10 | 1,800 | 68,580 | | | - | | 68,580 | |
| 45 | Shtet | 8505 | 771 | Ullishte | 6,465 | 998.43 | - | - | | | - | | - | |
| 46 | Demir Ali Nallbani | 8505 | 733/3 | Ullishte | 2,127 | 33.68 | 1,800 | 60,624 | | | - | 80,000 | 140,624 | |
| 47 | Hajrije Ali Agalliu | 8505 | 733/4 | Ullishte | 1,147 | 18.58 | 1,800 | 33,444 | | | - | 60,000 | 93,444 | |
| 48 | Shtet | 8505 | 735/4 | Ullishte | 1,515 | 24.50 | 1,800 | 44,100 | | | - | 30,000 | 74,100 | Kristaq Gallani (Okupuar) |
| 49 | Stavri Luci Duhanxhi & Aferdita Luci Naco | 8505 | 735/2 | Ullishte | 3,000 | 145.41 | 1,800 | 261,738 | | | - | 150,000 | 411,738 | |
| 50 | Shtet | 8501 | 18/321 | Truall | 51 | | | | 21.61 | 4,183 | 90,395 | | 90,395 | Hasan Iliaz Kokoshi (Okupuar) |
| 51 | Shtet | 8501 | 18/340 | Truall | 623 | | | | 28.26 | 4,183 | 118,212 | | 118,212 | Artan Jakup Kallanxhi (Okupuar) |
| 52 | Shtet | 8501 | 18/326 | Truall | 578 | | | | 16.38 | - | - | | - | |
| 53 | Shtet | 8503 | 18/324 | Truall | 286 | | | | 20.25 | 4,183 | 84,706 | | 84,706 | Mimoza Faslli Zykaj (Okupuar) |
| 54 | Shtet | 8505 | 755/1 | Ullishte | 343 | 3.53 | 1,800 | 6,354 | | | - | | 6,354 | Haki Molishti (Okupuar) |
| 55 | Algerta Vladimir Frasheri | 8505 | 733/1 | Ullishte | 4,000 | 176.24 | 1,800 | 317,232 | | | - | 70,000 | 387,232 | |
| | **Shuma** | | | | 128,447 | **9,116** | | 13,978,044 | **639.17** | | **1,022,953** | **1,399,000** | **16,399,997** | **LEKË** |

Shënim.

1. Vlerësimi i pasurisë është kryer bazuar në pikën 4, të nenit 17, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar.

**KËRKESË**
**Nr. 7257, datë 14.10.2020**

**PËR SHPRONËSIM**
**PËR INTERES PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të llojit "tokë truall", që preken nga projekti "Rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës 'Fortuzi'", Tiranë. Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private (sipas tabelës bashkëlidhur), të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.6.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë". Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, si dhe personat, të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë, çdo dokument që disponojnë, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë, mbi saktësimin dhe konfirmimin e pronësisë, sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

Vlera totale e shpronësimit është 28,046,617 (njëzet e tetë milionë e dyzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR
I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
**Artan Shkreli**

LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË QË PREKEN NGA PROJEKTI ME OBJEKT "RIKONSTRUKSIONI DHE ZGJERIMI I RRUGËS 'FORTUZI'", TIRANË

| Nr. | Emër Atësi Mbiemër | Lloji i pasurisë | Z.K. | Nr. i pas. | Sip. e përgj. truall m² | Sip. e prekur truall m² | Çmimi për truall lekë/m² | Sip. e përgj. objekt m² | Sip. e prekur objekt m² | Çmimi për objekt lekë/m² | Vlera (truall i prekur) lekë | Vlera (objekt i prekur) lekë | Vlera (truall + objekt) lekë | Konfirmim i ASHK-së Tiranë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ilir Harxhi , Anila Harxhi | truall | 8360 | 6/39 | 175.7 | 59 | 66969 | 53.00 | 0 | | 3951171 | 0 | 3951171 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 | |
| 2 | Dajana Ylber Berisha Nikoleta Ndoc Berisha, Ermal Ylber Berisha | truall | 8360 | 6/398 | 166 | 166 | 66969 | | | | 11116854 | | 11116854 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 706/1, datë 25.6.2020 | Mbi këtë truall është regjistruar ndërtesa me nr. pas. 6/37 ND vol. 31 FQ128 përfituar me l. leg. (ndërtesa nuk preket nga Projekti) |
| 3 | Gjovalin Llesh LLeshi | truall | 8360 | 6/277 | 154 | 55 | 66969 | | | | 3683295 | | 3683295 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 | Ka ndërtim pa leje |
| 4 | Arlind Kruja ,Elizabeta Kruja, Klajd Kruja, Xhavit Kruja | truall | 8350 | 5/344 | 10.8 | 10.8 | 66969 | | | | 723265 | | 723265 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 706/1, datë 25.6.2020 | Ka 1 ndërtim pa leje |
| 5 | ENILDA PETRIT CAUSHI,ARJANA PETRIT CAUSHI, BARDHYL MYNYR CAUSHI, MARGARITA ISA CAUSHI | truall | 8350 | 5/289 | 110 | 24 | 66969 | | | | 1607256 | | 1607256 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 | |
| 6 | MUHARREM ISA ISAJ | truall | 8350 | 5/305 | 12 | 12 | 66969 | | | | 803628 | | 803628 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 706/1, datë 25.6.2020 | |
| 7 | AISHE HAMIT HOXHA,FATMIR HAMIT KARAJ,IKBALE HAMIT DAJA,KLARITA MUSTAFA KARAJ, LAVDIJE HAMIT IMAMI,MERSIDA MUSTAFA KARAJ,MUHAMED HAMID KARAJ, SUZANA HAMIT ALLA, VIOLETA KARAJ | truall | 8350 | 6/274 | 76 | 15 | 66969 | | | | 1004535 | | 1004535 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 | |
| 8 | LULZIM MEHMET FORTUZI | truall | 8350 | 6/426 | 29 | 15 | 66969 | | | | 1004535 | | 1004535 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 706/1, datë 25.6.2020 | Ka 1 ndërtim pa leje |
| 9 | JALLDIS ISMAIL FORTUZI, PRANVERA YLBER FORTUZI, SUELA YLBER FORTUZI | truall | 8350 | 6/427 | 54 | 14 | 66969 | | | | 937566 | | 937566 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 | Ka 2 ndërtime pa leje |
| 10 | FRANKO ANESTI KONDAKCI | truall | 8350 | 6/430 | 18 | 6 | 66969 | | | | 401814 | | 401814 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 | |
| 11 | Bardhyl Mynyr Çaushi, Shkelqim Et'hem Çuni | truall | 8350 | 5/290 | 109 | 30 | 66969 | | | | 2009070 | | 2009070 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 | |
| 12 | Caje Alliu, Naile Kasmi, Hajrie Kasmi Mustafa Kasmi Irina Kasmi Hysen Kasmi Hasan Kasmi | truall | 8360 | 6/739 | 12 | 12 | 66969 | | | | 803628 | | 803628 | Konfirmohet me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 | |
| **Shuma** | | | | | | **419** | | | | | **28046617** | | **28046617** | | |

**Shënim.**

1. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen me shkresën nr. prot. 2970/1, datë 14.8.2019 dhe shkresën nr. prot. 706/1, datë 25.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore Tiranë.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, datë 3.2.2016.

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 184
Datë: 2020/10/16 13:01:16
88ea01fb-b8a3-4add-836f-d8b34ad180c0

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë